



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 176/1 Prot

Elbasan, më 15.2.2021


Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.2, datë 29.01.2021 " Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Klevis XHOXHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 665/prot

Dt. 4.02.2021

Nr.2 dt. 29.01. 2021

**Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtezuar për Bllok Ndihmën
Ekonomike deri në 6%**

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenëve 12, pikat 1, 4, 5 të ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, të ndryshuar" të Vendimit nr.597 datë 04.09.2019 të Keshillit të Ministrave për "Përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmes ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar për ndihmën ekonomike" Kreu IV "Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar për ndihmën ekonomike" ku thuhet se : **Keshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhenien e ndihmes ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikezimit, duke përdorur deri në 6% nga fond i kushtezuar për bllok ndihmën ekonomike, familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar mbrenda tre muajëve të fundit nepermjet regjistrit elektronik që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikezimit dhe se masa e ndihmes ekonomike për familjet përfituese llogaritet sipas strukturës së familjes përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.** Me propozim të strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale, Keshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 29.01.2021:

VENDOSI:

1. Për të përfituar nga fondi 6% i bllok ndihmes ekonomike, familjet përfituese nga ky fond duhet të jenë shpallur në Vendimin e Drejtorisë Rajonale "Nuk ka marrë piket e mjaftueshme" nga sistemi i pikezimit si dhe duhet të jepet përparësi familjeve që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. Të jenë familje me kryefamiljare Gra
- b. Të jenë familje që kanë në përbërjen e tyre Personë me Aftësi të kufizuar apo Invalide Pune
- c. Të jenë familje në gjendje të dobët Ekonomike (Verifikuar nga Administratori Shoqëror)
- d. Të jenë familje me shumë antare.
- e. Të jenë familje me femijë jetim ose në kujdestari të këtyre femijëve
- f. Të jenë familje me probleme Sociale.

2. Për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të jete kryer paraprakisht vlerësimi social ekonomik në familje nga administrator shoqëror sipas formularit tip të verifikimit dhe që ruhet në dosjen e dokumentave të aplikantit pranë njësive vendore dhe që i bashkëngjitet Pr/Vendimit të ardhur nga Njësia Administrative.

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Menaxhimit Financiar, Sektori i Ndihmes Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale.

4. Ky vendim hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Sek. i Keshillit
Elson Malluta



KRYETARI I KËSHILLIT
Shefki Bahiti